

PROGRAMI I LËNDËS SË MUZIKËS DRAFT



Qershor 2014

SHKALLA E PARË DHE E DYTË

Përmbajtja e Programi

I. Hyrje	Error! Bookmark not defined.
II. Korniza konceptuale e programit.....	6
1. Qëllimet e programit të muzikës	9
2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës	10
3. Lidhja e muzikës me temat ndërkurrikulare.....	13
4. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare.....	13
5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj	Error! Bookmark not defined.
6. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë.....	19
III. Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë.....	20
1. SHKALLA E PARË.....	21
1.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor.....	21
1.2 Tematika: Teknika dhe procese muzikore	26
1.3 Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria	30
2. SHKALLA E DYTË.....	Error! Bookmark not defined.
2.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor.....	32
2.2 Tematika: Teknika dhe procese muzikore	35
2.3 Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria	39
IV. Udhëzime metodologjike	44
V. Udhëzime për vlerësimin	46
VI. Materiale dhe burime mësimore.....	46

Tabelat dhe digramat

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	8
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e parë dhe të dytë.	11
Digrama 3: Lidhja ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera.	15
Digrama 4 : Komptencat e lëndës dhe tematikat e lëndës.	17
Tabela 1: Komptencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës	18
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	19

GRUPI I PUNËS

Majlinda Hala

Fatbardh Leka

Aurela Zisi (klasa përgatitore)

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Mësimi i arteve u afron nxënësve mundësi për të zhvilluar njohuritë artistike përmes mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, formave, fjalës, lëvizjeve. Ato mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave e proceseve artistike, nxisin të mësuarit konkret të artit gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme. Kompetencat përmbajtësore që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët, kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyç, në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë, kërcim dhe dramë* si lëndë të detyrueshme në *shkallën 1, shkallën 2 dhe shkallën 3*. Fusha e arteve *në shkallën e parë* fokusohet në ndërgjegjësimin e nxënësve për njohjen e dukurive, fenomeneve, objekteve dhe situatave artistike në mjedisin që i rrethon. *Në shkallën e dytë*, fusha e arteve fokusohet në aftësimin e nxënësve në vëzhgimin, reflektimin, komunikimin dhe përdorimin e informacionit nga burime të ndryshme. Artet janë konceptuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar, për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën artistike, kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit, ndihmojnë në krijimin dhe zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare si dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve.

I. Muzika

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit. Kjo tregon që muzika krijon edhe historinë e vet përmes kultivimit e sofistikimit të “këngës” primitive dhe kultivimin e përpunuar të zërit njerëzor e të instrumenteve të muzikës. Të gjitha këto të bashkërenduara e të nënrenduara në procesin e edukimit, do të kërkojnë të trajtohen në mënyrë të përveçuar e sistematike në këtë program lëndor sipas shkallëve. Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe ndërtimit të tyre, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimi të muzikës.

Njohja me muzikën është një vlerë e madhe për të mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Integrimi i muzikës me të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve dhe me fushat e tjera të kurrikulës, si dhe me temat ndërkurrikulare ka qëllim që të zotërohen sa më mirë *kompetencat kyçe*. Muzika është e pranishme në aktivitetet tona të përditshme (p.sh.klasë, shtëpi, tv, film, koncert, teatër, kolonë zanore, ngjarje të shënuara familjare, veprimtari brenda dhe jashtë shkollës, ngjarje të komunitetit etj.). Muzika nuk mund të kuptohet pa marrjen e disa njohurive themelore bazë si njohja me *gjuhën muzikore dhe komunikimin përmes saj, zbatimin përmes teknikave dhe proceseve muzikore, njohja me zhvillimin historik të saj dhe lidhjen e ngushtë me njeriun*, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësit për rolin e muzikës në jetën e përditshme.

Me anë të muzikës, nxënësit mësojnë dhe interpretojnë këngë dhe lojëra muzikore përmes teknikave të këndimit, zbatojnë modele ritmike përmes njohjes me ritmet, luajnë me instrumentet, përmes zbatimit të teknikave të luajtjes me to, kuptojnë krijimin e muzikës, përmes njohjes së fenomeneve dhe dukurive muzikore në natyrë etj.

Artet janë një nga shtatë fushat e kurrikulës së arsimit bazë dhe e cila përmban katër lëndë brenda saj: Arti pamor, *muzika*, drama dhe kërcimi. Muzika mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës.

Në shkallën e parë dhe të dytë muzika zhvillohet përmes njohjes me dy shtyllat bazë të saj *ritmit* dhe *melodisë*. Ritmi zbulohet në mjedisin përreth dhe më pas në muzikë, përfjetohet duke provuar modele të ndryshme ritmike dhe krijohen ritme me dy, tri dhe katër goditje. Edhe tingujt zbulohen në mjedisin përreth dhe përcaktohen karakteristikat e tyre me fjalë të thjeshta. Këngët dhe lojërat didaktike për fëmijë, këngët dhe lojërat popullore, të përshtatshme për nga karakteri, përmbajtja e shtrirja, me dhe pa shoqërim instrumental, mësohen duke formuar kështu një kulturë vokale, përmes teknikave të kënduarit dhe kërkesave të këndimit: *pozicioni, frymëmarrja, artikulimi i fjalëve* etj. Luajtja me instrumente me goditje, shoqërimi i këngëve dhe lojërave muzikore, krijimi i modeleve ritmike përmes ligjërimit të vargjeve, shoqërimin me lëvizje trupore, me shuplaka, janë veprimtari që zhvillohen në këtë nivel.

Muzika, u afron nxënësve *kënaqësinë* që afron dëgjimi i një vepr¹ apo krijimi të caktuar muzikor, *aspektet “prozaike”* të saj, *faktorët* që e bëjnë të mundur ekzistencën e veprës si të tillë ose të atillë; *mekanizmin* që e vë në lëvizje *përfytyrimin e figurës së tingujve* dhe gjithë arsenalin e mjeteve që përcaktojnë *pamjen tërësore të muzikës*.

Lënda e muzikës synon të edukojë dhe formojë nxënësit nga pikëpamja muzikore, duke i orientuar ata me kreativitet drejt kuptimit të veçorive të ligjërimit muzikor nga më e thjeshta te më e ndërlikuara përmes gjuhës dhe komunikimit muzikor, drejt marrjes pjesë dhe interpretimit në veprimtaritë muzikore individuale dhe në grup përmes teknikave dhe procesit muzikor, drejt formimit dhe krijimit të një vlerësimi dhe qëndrimi artistik në njohjen me veprat muzikore.

¹ Veprat muzikore do të vendosen për dëgjim për të sjellë shembuj konkretë të shpejtësisë së ritmit, karakterit muzikor, të karakteristikave të tingujve, apo karakteristikave të formës apo gjinisë muzikore.

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** , për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së muzikës, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- **Mësuesit** , për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** , për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i muzikës ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i **temave ndërkurrikulare** nëpërmjet lëndës së muzikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e muzikës dhe të gjitha arteve të tjera që përbëjnë fushën e arteve, në shoqëri dhe në jetën e përditshme.


Programi përmban **3 tematika** të cilat janë të përbashkëta në të gjitha disiplinat artistike të fushës së arteve, e krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e muzikës dhe fushave të tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie në muzikë është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik, që zotëron brenda vetes. Në këtë program ***vlerësimi i nxënësve*** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i muzikës, të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit



Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi/ja:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

1. Qëllimet e programit të muzikës

Programi i Muzikës, nëpërmjet përmbajtjeve të tematikave, ka si qëllim zhvillimin e njohurive dhe koncepteve bazë për formimin artistik në muzikë, përmes zbulimit të dukurive dhe fenomeneve muzikore nga mjedisi, zhvillimin e aftësive muzikore, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të muzikës shqiptare dhe asaj botërore, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike. Ata do të përfshihen në veprimtari muzikore tradicionale, duke manifestuar vlerat e muzikës kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, marrin pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit ,ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprojnë në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, krijojnë dhe realizojnë punë të ndryshme muzikore, japin kontributin personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Në programin e muzikës nxënësi mëson të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive dhe fenomeneve muzikore, eksperimenton me ritmin dhe melodinë, duke i gjetur ato në mjedisin e tyre të përditshëm. Ai kupton dhe argumenton qëndrimet e veta, duke ia paraqitur të tjerëve, edukohet të punojë në grup, ndihet i suksesshëm në muzikë.

2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies. **Kompetenca** përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimin të muzikës me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësi realizon kompetencat muzikore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. Psh.: kompetenca e muzikës “Interpretimi dhe performimi i veprave” (këngëve dhe lojërave muzikore) përfshin shumë nga teknikat e të kënduarit apo luajtjes me instrumente muzikore, por jo vetëm kaq, në arritjen e kësaj kompetence ndihmojnë dhe procese të tilla si improvizimi, interpretimi, analizimi tekstual dhe muzikor i këngëve dhe lojërave që këndojnë apo i veprave muzikore që dëgjojnë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së muzikës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së muzikës që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së muzikës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave muzikore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t’i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e muzikës.

Digrama 2: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e parë dhe dytë.

SHKALLA E PARË	SHKALLA E DYTË
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike. • Kupton simbolet muzikore që u drejtohen. • Shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve 	<ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike. • Kupton mesazhet nëpërmjet simboleve muzikore që u drejtohen.

<p>muzikore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve dhe formave artistike. • Komunikon në mënyrë të pavarur dhe krijuese mundësitë e të shprehurit në muzikë.
Kompetenca e të menduarit	Kompetenca e të menduarit
<ul style="list-style-type: none"> • Mendon në mënyrë krijuese. • Merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese. • Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese. • Kupton ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mendon në mënyrë krijuese në situata të ndryshme të të menduarit. • Përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi. • Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese. • Demonstron realizimin e një krijimi/interpretimi në një veprimtari muzikore.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor. • Përdor burime e gatshme për të realizuar një krijim muzikor. • Zbaton detyrën e dhënë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor mjetet për të realizuar një krijim muzikor. • Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim muzikor. • Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën muzikore.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
<ul style="list-style-type: none"> • Bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.
Kompetenca personale	Kompetenca personale
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore. • Respekton punën e vet dhe të tjerëve • Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave. 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon besimin tek vetja gjatë krijimit/performimit/vlerësimit muzikor respekton punën e vet dhe të tjerëve • Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.
Kompetenca qytetare	Kompetenca qytetare
<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
Kompetenca digjitale	Kompetenca digjitale

- Njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

- Përdor mjetet: magnetofon, video CD, DVD, kompjuter etj.

3. Lidhja e lëndës së muzikës me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Muzika ka një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; trashëgimia kulturore; të drejtat e njeriut; mjedisi*, ku nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve muzikore, duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme, duke dhënë kontributin e vet në mbrojtjen e mjedisit, duke u dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme muzikore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë muzikore për të komunikuar vlera dhe qëndrime për një bashkë jetesë paqësore ndërmjet kulturave, çështje që lidhen edhe me fusha të tjera që ata mësojnë.

Përmes projekteve të ndryshme në fushën e arteve, ata mund të komunikojnë dhe shprehën përmes gjuhës muzikore, për të krijuar një punë të vetën muzikore, duke eksperimentuar, zbuluar dhe zhvilluar më tej informacionin dhe idetë muzikore, duke organizuar krijimet muzikore sipas elementeve të gjuhës muzikore në një kontekst të caktuar historik dhe kulturor.

4. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempi, forma, historia etj., lidhen shumë mirë me lëndët e tjera artistike, brenda fushës, por disa koncepte studiohen në disa fusha të tjera në kontekstin e objektit të studimit që ata kanë, si: matematika, gjuha dhe komunikimi, shkencat shoqërore dhe


natyrore, edukimi fizik, sporti dhe shëndeti, TIK-u. Kështu që në arsimin fillor, mësuesit përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë fëmijëve/nxënësve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtijshëm këtyre përvojave. Gjatë studimit të fenomeneve dhe dukurive muzikore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën e komunikimit dhe të përdorin drejt gjuhën dhe terminologjinë artistike. Nëse nxënësit shprehin rrjedhshëm mendimet e tyre rreth informacioneve muzikore në veçanti dhe atyre artistike në përgjithësi, ata zhvillojnë saktë kompetencën e komunikimit të gjuhës. Por njëkohësisht edhe lëndët brenda fushës së arteve kontribuojnë në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit artistik të nxënësve duke i nxitur ata të parashtrajnë qartë dhe saktësisht idetë e tyre përmes komunikimit apo përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve krijuese dhe shpjegimit të rezultateve të tyre e krijuar një fjalor artistik.

Studimi i muzikës lidhet me fushën e shkencave shoqërore, pasi nëpërmjet saj nxënësit marrin informacion mbi historitë e zhvillimit të arteve në periudha të caktuara historike në vende, kontekste dhe kultura të ndryshme. Duke hedhur vështrimin nga e kaluara historike mund të marrin përgjigje si ka evoluar muzika. Kështu nëse nxënësit bëjnë kërkime dhe prezantojnë informacionet muzikore qartë, ata zhvillojnë kompetencën e komunikimit, digjitale, personale etj.

Fusha e arteve lidhet me fushën e shkencave natyrore, pasi disa teknika specifike të fushës së arteve zbatohen nëse njihen mirë ligjet e fushës së shkencave .P.sh. për të kryer lëvizjet e trupit një kërcimtar mund të arrijë performancën më të lartë, nëse njihet mirë ligjet e dinamikës. Por njëkohësisht duke shfrytëzuar programet e arteve pamore nxënësi bëhet njohës i mirë i figurave dhe trupave gjeometrikë në hapësirë dhe plan.

Tik-u mbështet kërkimin e mjaft proceseve në fushën e arteve dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin. Për shembull nëpërmjet përdorimit të Tik-ut nxënësit diskutojnë dhe ndajnë idetë e tyre mes njëri –tjetrit. Nxënësit mund të zbulojnë dhe vizualizojnë koncepte të ndryshme të fushës së arteve duke përdorur mjete për të ndryshuar për prezantimin e tyre.

Digrama 3: Lidhja ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera



5. Kompetencat që formohen përmes tematikave

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e muzikës synon të ndërtojë dhe zhvillojë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës së tij dhe që përmbushen përmes njohurive të zhvilluara nëpërmjet 3 tematikave kryesore

Kompetencat e lëndës:

Kompetenca 1: Krijimi muzikor.

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor.

Kompetenca muzikore 3: Vlerësimi i veprave muzikore.

Tematikës e lëndës:

Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi muzikor.

Tematika 2: Teknikat dhe proceset muzikore.

Tematika 3: Historia, muzika dhe shoqëria.

Digrama 4 : Kompetencat që formohen përmes tematikave




Tabela 1: Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre

Kompetencat e veçanta	Përshkrimi i kompetencave
<p align="center">Krijimi muzikor</p>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor ide të ndryshme, duke përdorur elementet dhe gjuhën muzikore; - eksperimenton duke zbuluar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike; - organizon krijimin e vet muzikor, sipas elementeve të gjuhës muzikore ; - ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.
<p align="center">Performimi/interpretimi muzikor</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të ndryshme muzikore (këngë /lojëra muzikore, fragmente muzikore); - njih dhe zbaton teknika dhe procese të ndryshme muzikore gjatë këndimit dhe luajtjes me instrumente; - respekton rregullat e performimit/interpretimit muzikor gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente; - ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.
<p align="center">Vlerësimi i veprave muzikore</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon me fjalor të thjeshtë këngë/lojëra dhe veprat muzikore të thjeshta.

6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e muzikës zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë. Në klasën përgatitore, kohëzgjatja e “orës së mësimi” llogaritet me 25-30 minuta. Programi i lëndës së muzikës specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa përgatitore	10	20	5	35 orë
Klasa e parë	6	24	5	35 orë
Klasa e dytë	8	22	5	35 orë
Shkalla e parë	24	66	15	105 orë
Klasa e tretë	8	22	5	35 orë
Klasa e katërt	9	20	6	35
Klasa e pestë	10	19	6	35 orë
Shkalla e dytë	27	61	17	105 orë

III. Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë

Në programin e lëndës muzikë për shkallën e parë dhe të dytë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave si më poshtë:

- *Gjuha dhe komunikimi muzikor.*
- *Teknika dhe procese muzikore.*
- *Historia, muzika dhe shoqëria.*

Këto tematika, janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipas kompetencave muzikore, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Për secilën tematikë, sipas klasave të shkallës janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të shkallës së parë (*klasa përgatitore, klasa e parë dhe klasa e dytë*) dhe shkallës së dytë (*klasa e tretë, klasa e katërt, klasa e pestë*). Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle për secilën shkallë.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk do të thotë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave në këtë renditje. Kombinimi, ndarja e njohurive dhe koncepteve muzikore në grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesit dhe autorët e teksteve).

Për “përkthimin” e programit të shkallës në tekste mësimore apo programe lëndore për çdo vit mësimor, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në tematika dhe njësi mësimore të zhvilluara logjikisht.

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ndërsa janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Në program, për secilën klasë, afërsisht 40 % e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe 60 % e tyre janë menduar për krijimin e aftësive dhe situatave të të nxënit (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE

SHKALLA E PARË: KLASA PËRGATITORE, KLASA E PARË, KLASA E DYTË

1.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor²

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Në këtë tematikë nxënësi/ja kërkon, zbulon burime të ndryshme të dukurive dhe fenomeneve natyrore për të kuptuar gjuhën muzikore. Ai/ajo fillon të kuptojë këto elemente muzikore duke eksperimentuar dhe filluar të ndërtojë njohuritë e veta mbi dukuritë muzikore. Ndërsa edukimi me ritmin dhe melodinë, fillon që në klasat parapërgatitore ku fëmijët zbulojnë elementet tingullore dhe ritmike nga mjedisi, i provojnë dhe i përjetojnë ato në forma të ndryshme përmes dëgjimit, krijimit, këndimit. Pra, dukuritë muzikore dhe muzika, përjetohe e zbatohen në forma konkrete.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor:* kërkon dhe zbulon elementet muzikore në mjedisin përreth e tyre, në natyrë dhe në muzikë; identifikon shumëllojshmëri burimesh ritmike dhe melodike (tingullore); imiton dhe demonstroi kuptimin e karakteristikave të tingujve muzikorë ose jo muzikorë; improvizon modele të ndryshme ritmike ose jo-ritmike.
- *Performimi/interpretimi muzikor:* interpreton gjatë këndimit, duke kënduar ëmbël, ngadalë apo shpejt –ngadalë, etj.; demonstroi gjatë luajtjes me mjetet trupore apo instrumentet fëminore se ka kuptuar elementet e ritmit dhe melodisë.
- *Vlerësimi i veprave muzikore:* shpreh qartë mendimin e vet gjatë shpjegimit emocional të këngës, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë muzikor për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e veta muzikore.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA PËRGATITORE

² Njohuritë dhe konceptet e kësaj tematike, do të trajtohen tek tematika e tretë “Historia, muzika dhe njeriu” nëpërmjet dëgjimit të fragmenteve të pjesëve muzikore ku dalin dukshëm njohuritë dhe konceptet muzikore të trajtuara në tematikën e parë. Përveç kësaj në tematikën e tretë nxënësit edukohen të dëgjojnë dhe jenë të vëmendshëm gjatë dëgjimit, jo vetëm për të zbuluar karakteristikat e tingujve, ritmeve, shpejtësisë apo ngjyrimit, por të zhvillojnë aftësitë për të identifikuar gjuhën muzikore në pjesët që dëgjojnë dhe edukohen për një dëgjim të shpeshtë dhe të drejtë të muzikës, duke arritur të ndjejnë emocionalisht veprën muzikore dhe gjykojnë e vlerësojnë, duke komunikuar artistikisht për to.

› **Ritmi dhe burimet e tij:**

- Nga mjedisi përreth.
- Në natyrë.
- Karakteristikat e ritmit.

› **Tingujt dhe burimet e tyre:**

- Tingujt në mjedisin përreth.
- Tingujt në natyrë.
- Tingujt në muzikë.
- Karakteristikat e tingullit.

- Përjeton ritmin e prodhuar nga burime ritmike në mjedisin rrethues, si: çak-çak-goditja e çekiçit, tik-tak – rrahja e orës etj.
- Përjeton ritmin e prodhuar nga burime ritmike në natyrë: troku i kalit trak-trok, kuak-kuak-un e bretkosës, mjaullimën e maces mjau-mjau etj.
- Imiton goditjet ritmike që dallon në natyrë dhe në mjedisin rrethues.
- Krijon modele ritmike duke përdorur mjetet trupore *shuplakat dhe këmbët dhe objekte të ndryshme me goditje.*
- Nxjerr tinguj të ndryshëm duke luajtur me *zërin.*
- Dallon tinguj që prodhohen në natyrë, si: cicërima e zogut, lehja e qenit, fëshfërima e gjetheve, gurgullima e ujit etj.
- Dallon tinguj që ndeshen në mjedisin rrethues, si: boria e makinës, zilja e shkollës, zërin e prindërve, të shokëve etj.
- Imiton tingujt, zhurmat, zërat e ndryshëm, rrahjet që dëgjon në mjedisin përreth.
- Dallon tingujt që lëshojnë të paktën 2-3 vegla muzikore.
- Jep disa karakteristika të tingujve që dëgjon, si: i trashë, i hollë, i lartë, i ëmbël etj.

KLASA 1

› **Ritmi dhe burimet e tij:**

- *Ritmi* në mjedis dhe ndryshueshmëria e goditjeve të tyre.
- Ritmi me dy goditje në natyrë dhe në mjedisin përreth.
- Ritmi me dy goditje në muzikë – i gjatë i shkurtër.
- *Ritmi* dhe ndryshueshmëria e goditjeve gjatë

- Zbulon dhe përjeton ritmin në mjedisin përreth dhe natyrë, duke i imituar ato nëpërmjet goditjeve ritmike.
- Krijon modele ritmike dhe kupton ndryshueshmërinë e goditjeve *ritmike* ose *joritmike* përmes *duartrokitjeve me shuplaka.*
- Percepton ritmin si fenomen muzikor.
- Përjeton modele ritmike të ndryshme nëpërmjet *goditjeve dyshe.*
- Krijon simbole personale për goditjet që përbëjnë ritmin – *goditjet e gjata dhe të shkurtra.*

dëgjimit.

- *Ritmi me mjete trupore* - duartrokitjet me shuplaka.
- *Tempi* - shpejtësia e ritmit, *ngadalë –shpejt*.

› **Tingulli dhe burimet e tij:**

- › Tingujt natyrorë.
- › Tingujt njerëzorë.
- › Tingujt muzikorë.
- › Tingujt e dëmshëm.
- › Ndryshueshmëria e tingujve dhe karakteristikat e tyre (*fortë – butë, i lartë - i ulët*).

› **Timbri / ngjyra :**

- E tingujve nga natyra.
- Zërave njerëzore.
- E instrumenteve.
- Karakteristikat dhe ndryshueshmëria e tyre.

- Zhvillon vëmendjen dhe kujtesën për të imituar ritme të ndryshme.
- Dëgjon fragmente muzikore dhe identifikon llojin e tempit (*ngadalë-shpejt*).
- Dëgjon fragmente muzikore ose këngë për fëmijë dhe kupton shpejtësinë e tyre, duke iu përgjigjur fragmenteve të shkurtra muzikore përmes lëvizjeve trupore, me *hapa normalë*, apo *marsh*, (*shpejtësia e muzikës*).
- Prezanton lirshëm mendimin e vet rreth ritmeve në natyrë, në mjedisin përreth apo në muzikë.
- Zbulon dhe përjeton përmes dëgjimit tingujt e ndryshëm nga natyra apo mjedisi përreth: *shiu kur bie, bubullimat, era kur fëshfërin, boritë e makinave, qentë kur lehin, kukuvajka, macja kur mjaullin, lumi kur rrjedh i qetë*.
- Zbulon dhe përjeton përmes dëgjimit tingujt e ndryshëm njerëzore *foshnjat kur qajnë, njeriu kur flet, njeriu kur këndon, kur bërtet etj*.
- Zbulon dhe përjeton përmes dëgjimit tingujt e ndryshëm muzikorë *violina, flauti, çiftelia etj*.
- › Zbulon tingujt që nxjerrin instrumentet: *trekëndëshi, shkopinjtë, zilka/këmbora*, duke kuptuar ndryshueshmërinë e tingujve që lëshon secila prej tyre nga forma dhe materiali.
- Përcakton karakteristikat dhe ndryshimet e tingujve që dëgjojnë në jetën e përditshme dhe nga muzika, duke i shpjeguar me fjalë të thjeshta, p.sh.:
Tingujt nga natyra - zëri i zogut dhe zëri i luanit (ndryshimet).
Zërat e njerëzve - zëri i gruas dhe zëri i burrit (ndryshimet).
Tingujt nga instrumentet - tingëllimi i instrumenteve me goditje të prodhuara vetë në shtëpi apo klasë; tingulli i një instrumenti muzikor, p.sh., violinës, dhe i kontrabasit (ndryshimet).
Tingujt që lëshon trupi - tingëllimi i mjeteve trupore (trokitje e trupit, duarve, këmbëve,

fishkëllima).

- Dallon *ngjyrimin e zërit* të shokut apo shoqes gjatë këndimit.
- Zhvillon vëmendjen dhe kujtesën për të mbajtur mend tinguj të ndryshëm që dëgjon.
- Komunikon lirshëm mendimin e vet rreth tingujve natyrorë, njerëzore dhe muzikore.

KLASA 2

> Ritmi dhe burimet e tij:

- Ritmi me dy goditje .
- Theksi në fjalët me dy rrokje.
- Theksi në muzikë tek modelet me dy goditje.
- *Mjetet trupore - ritmi* përmes duartrokitjeve me shuplaka.
- *Tempo* - shpejtësia e ritmit, *shumë ngadalë – shumë shpejt*.

> Tingulli dhe burimet e tij:

- Tingujt natyrorë.
- Tingujt njerëzorë.
- Tingujt muzikorë.
- Tingujt e dëmshëm.

> Karakteristikat e tingujve dhe ndryshueshmëria e tyre: (*fortë – butë; shumë i fortë – shumë i butë; i lartë - i ulët; shumë i ulët – shumë i lartë*).

> Timbri / ngjyra :

- Identifikon shembuj të *ritmit* me dy goditje *në mjedis* dhe më gjerë, duke kuptuar që ato kanë vetëm dy rrahje (goditje).
- Gjen *fjalë me dy rrokje* dhe kupton ku bie *theksi* gjatë shqiptimit të fjalës.
- Identifikon në vargjet e një vjershe, p.sh., *fjalët me dy rrokje*.
- Krijon modele me dy goditje dhe thekson goditjen e parë.
- Përjeton dhe percepton ritmin si fenomen muzikor, duke krijuar *simbole grafike* personale.
- Improvizon në përshtatje me ritmin dhe melodinë, lëvizje të ndryshme trupore.
- Shpik/krijon modele të thjeshta me dy goditje, duke përdorur zërin, objekte të ndryshme që prodhojnë ritëm, instrumentet me goditje, mjetet trupore.
- Përjeton rrahjen me dy goditje në muzikë, p.sh., *marsh*, duke rrahur/mbajtur ritmin me dy goditje, *këngë (2/4)* (njëri grup mban ritmin e një kënge me instrumente me goditje, ndërsa grupi tjetër këndon këngën) etj.
- Identifikon nga burime të ndryshme në jetën e përditshme disa *karakteristika* të tingujve si (*i shpejtë, i rëndë, i fortë, i frikshëm etj.*), p.sh.:
 - bubullimat janë *shumë të forta*;
 - boritë e makinave janë *të bezdisshme*;
 - shiu bie *shpejt* dhe me *furi*, por bie dhe *qetë e ngadalë*;
 - ulërima e ujkut – *e lartë dhe e gjatë*;

- E tingujve nga natyra.
- Zërave njerëzore.
- E instrumenteve.
- Karakteristikat dhe ndryshueshmëria e tyre.

> Dinamika në muzikë:

- Shenjat e ngjyrimit
piano p
forte f
mezo forte - mf

> Përdorimi i teknologjisë:

- Tinguj të prodhuar nga mjete të ndryshme teknologjike

- cicërima – *e ëmbël etj.*;

- Përshkruan disa karakteristika të zërave të burrave, grave dhe fëmijëve, duke i shprehur ato me fjalë të thjeshta, p. sh.: *mësuese X e ka zërin shumë të ëmbël, ndërsa mësues Y e ka zërin më të fortë; Beni e ka zërin më të lartë se zëri i Mirës;*
- Identifikon tinguj nga natyra, njerëzore dhe instrumentet muzikore, duke përcaktuar gjatë dëgjimit, tingujt p.sh.:
 - *ujku, zog, bretkosa, lopa –tinguj natyrorë;*
 - *zëri i motrës, vëllait, babait, mamasë, shokëve/shoqeve – tinguj vokalë ose njerëzorë;*
 - *tingulli i pianos, kitarës, violinës etj. – tinguj instrumentesh – muzikorë.*
- Dallon ndryshimin e ngjyrimit të zërit të shokut dhe të shoqes që ka në klasë apo lagje.
- Kupton ndërtimin e aparatit vokal të njeriut.
- Imiton fragmente shumë të shkurtra muzikore, duke e përdorur zërin në mënyra të ndryshme: *duke pëshpëritur, duke thirrur, duke fishkëllyer, duke folur, duke kënduar etj.*
- Zbulon duke eksperimentuar mbi tingujt që krijojnë disa instrumente nga goditja: *tamburi, shkopinjtë, zilka/këmbora, trekëndëshi* duke u shprehur me fjalët e tyre për ndryshueshmërinë e ngjyrimit të tingullit që dëgjon.
- Incizon tinguj të ndryshëm nga mjete të ndryshme teknologjike: magnetofon, kompjuter, etj.

1.2 Tematika: Teknika dhe procese muzikore

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Proceset muzikore që zhvillohen dhe përshkojnë muzikën në tërësi janë: këndimi, luajtja në instrumente muzikore për fëmijë, përjetimi, interpretimi, dëgjimi muzikor, krijimi, improvizimi, analizimi të cilat zhvillohen nëpërmjet teknikave të ndryshme të kënduarit, luajtjes në instrument, të dëgjuarit etj. Përmbajtja e këngëve për fëmijë ka një tematikë të caktuar : *himni, atdheu, familja, shoqëria, këngët patriotike dhe festat e ndryshme* etj., si dhe *këngë/lojë muzikore dhe popullore*. Ato janë didaktike dhe kanë vlera artistike muzikore - poetike, të cilat edukojnë për një qëllim të caktuar, ndaj tematika e tyre është e detyrueshme. Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga *shtrirja e regjistrimit vokal (zërit), melodia dhe ritmi*. Kryesisht tematika zhvillohet përmes procesit të këndimit dhe luajtjes me instrumente për fëmijë me goditje. Procesi i *këndimit* zhvillohet nëpërmjet mësimin të teknikave vokale si mënyrat e formësimit të zërit dhe të një kënduari të saktë në intonacion e ritëm, ndërsa procesi i *luajtjes me instrumente fëmijore* me goditje zhvillohet nëpërmjet mësimin të teknikave të luajtjes. Instrumentet trupore, instrumentet me goditje dhe ORF, të cilat do të jenë pjesë e shoqërimit të këngëve dhe improvizimit me to, apo të muzikës që nxënësit këndojnë, vallëzojnë dhe luajnë.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor* : demonstroi zbatimin e elementeve të gjuhës muzikore, gjatë krijimeve të ndryshme; komunikon njohuritë rreth gjuhës muzikore.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës; interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore; performon lojërat muzikore duke ndihmuar në inskenimin e tyre.
- *Vlerësimi i veprave muzikore*: shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon; përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional; përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA PËRGATITORE

> **Aparati i vokalit**
- Ndërtimi i aparatit vokal të njeriut.

<ul style="list-style-type: none"> > Këngë për fëmijë. > Rregullat e këndimit. > Këndimi solo dhe në grup. > Lojëra muzikore : <ul style="list-style-type: none"> - Të thjeshta për fëmijë. > Mjetet trupore: <ul style="list-style-type: none"> - Duartrokitje të shuplakave. - Duartrokitje të shuplakave mbi gjunjë. - Përplasja e këmbëve. > Instrumentet e perkusionit <ul style="list-style-type: none"> - Tamburi. - Shkopinjhtë. - Zilka/këmbora. - Trekëndëshi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Këndon këngë të thjeshta dhe të njohura për fëmijët e kësaj moshe. - Zbaton rregullat e këndimit: hapja e gojës, frymëmarrja, intonimi, qëndrimi, shqiptimi - Këndon dhe kryen lëvizje trupore gjatë këndimit. - Kryen lojëra muzikore sipas koreografisë së caktuar nga mësuesja. - Këndon solo dhe në grup. - Shoqëron këngët dhe lojërat me <i>mjete trupore dhe instrumente me goditje.</i> - Kryen me instrumente <i>goditje dyshe: një-dy, bam-bum, tak-tak etj.</i>
---	--

KLASA 1

<ul style="list-style-type: none"> > Aparatit i vokalit <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i aparatit vokal të njeriut > Këndimi solo dhe në grup > Këngë për fëmijë > Rregullat e këndimit: <ul style="list-style-type: none"> - Hapja e gojës - Frymëmarrja - Intonimi - Qëndrimi - Shqiptimi > Këngë & Lojëra muzikore për fëmijë 	<ul style="list-style-type: none"> - Këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla etj.), në kohët 2/4, ¾, 4/4 , me regjistër të thjeshtë vokal, me shtrirje brenda oktavës qendore, nga notat Do – Do². - Respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit. - Këndon <i>këngë</i> për fëmijë <i>solo dhe në grup.</i> - Interpretin këngët e mësuara natyrshëm, me emocion dhe ndjenjë. - Këndon dhe interpreton sipas një koreografie të ideuar për <i>këngë – lojëra muzikore</i> - Këndon dhe interpreton lojërat muzikore <i>popullore</i> për fëmijë të krahinës ose më <i>gjerë.</i> - Këndon dhe shoqëron këngët, lojërat muzikore, duke ndërthurur muzikën me lëvizjen.
--	---

<ul style="list-style-type: none"> > Mjetet trupore: <ul style="list-style-type: none"> - Duartrokitje të shuplakave. - Duartrokitje të shuplakave mbi gjunjë. - Përplasja e këmbëve. > Instrumentet të perkusionit: <ul style="list-style-type: none"> - Tamburi. - Shkopinjë. - Zilka/këmbora. - Trekëndëshi > Rregullat e luajtjes në instrument: <ul style="list-style-type: none"> - Qëndrimi . - Teknika të luajtjes me to. 	<ul style="list-style-type: none"> - Respekton gjatë këndimit <i>ritmin, intonacionin, rregullat e këndimit.</i> - Përjeton ritmin tek këngët ose lojërat muzikore, përmes <i>duartrokitjeve me shuplaka.</i> - Shoqëron lojërat muzikore dhe popullore me mjete trupore (shuplaka) apo me vegla me goditje (shkopinj, tambur, zilka etj). - Luan me instrumentet e thjeshta me goditje <i>tamburi, shkopinjë, zilka/këmbora, trekëndëshi.</i> - Improvizon mbi melodi të ndryshme, duke ndërthurur muzikën me lëvizjen.
--	---

KLASA 2

<ul style="list-style-type: none"> > Këndimi solo dhe në grup > Këngë për fëmijë > Rregullat e këndimit: <ul style="list-style-type: none"> - Hapja e gojës . - Frymëmarrja . - Intonimi . - Qëndrimi . - Shqiptimi. > Këngë & Lojëra muzikore/popullore për fëmijë > Mjetet trupore: <ul style="list-style-type: none"> - Duartrokitje të shuplakave. - Duartrokitje të shuplakave mbi gjunjë. - Përplasja e këmbëve. > Instrumentet të perkusionit <ul style="list-style-type: none"> - Tamburi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla etj.), në kohët $2/4, 3/4, 4/4$, me regjistër të thjeshtë vokal, me shtrirje brenda oktavës qendore, nga notat Do – Do². - Respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit. - Respekton gjatë këndimit <i>ritmin, intonacionin, rregullat e këndimit.</i> - Këndon këngë për fëmijë <i>solo dhe në grup.</i> - Interpretin këngët e mësuara me emocion dhe ndjenjë. - Këndon dhe performon sipas një koreografie të ideuar për <i>këngë – lojëra muzikore.</i> - Këndon dhe interpreton lojërat muzikore <i>popullore</i> për fëmijë të krahinës ose më tej; - Këndon dhe shoqëron këngët, lojërat muzikore, duke ndërthurur muzikën me lëvizjen; - Përjeton përcjelljen ritmike tek këngët ose lojërat muzikore (<i>kryesisht me dy goditje</i>) përmes <i>duartrokitjeve me shuplaka.</i> - Ndërton instrumente të thjeshta me goditje me materiale të ndryshme rrethore dhe shoqëron
--	---

- Shkopinjhtë.
- Zikla/këmbora.
- Trekëndëshi.
- Dajre.

› **Rregullat e luajtjes në instrument:**

- Qëndrimi
- Teknika të luajtjes me to

këngët dhe lojërat muzikore.

- Shoqëron lojërat muzikore dhe popullore me mjete trupore (shuplaka) apo me vegla me goditje (shkopinj, tambur, zilka etj).
- Luan me instrumentet e thjeshta me goditje *tamburi, shkopinjhtë, zikla/këmbora, trekëndëshi.*
- eksperimenton mbi tingujt që lëshojnë instrumentet, duke zbuluar *ndryshueshmërinë e tingujve* që lëshojnë ato *përmes goditjeve*, p.sh., nga goditje në dy pjesë të ndryshme të tamburi *në qendër dhe në cep të saj, me goditje të lehta dhe të forta* (përftimi i dy tingujve të ndryshëm);
- Regjistron këngët dhe krijimet e tyre (imitime, këngë etj.) në magnetofonin e klasës, shkollës.

1.3 Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Mendimi muzikor është një element shumë i rëndësishëm i cili shprehet përmes emocioneve njerëzore. Edhe muzika krijon emocione, që shprehin: dashuri, kënaqësi, keqardhje, gëzim, shpresë, mërzi. Edukimi përmes dëgjimit muzikor të këngëve apo pjesëve të ndryshme muzikore kultivon tek nxënësit dëshirën për muzikën dhe i bën ata të vetëdijshëm ndaj muzikës ata dëgjojnë.

Fragmente të vogla muzikore të huaja dhe shqiptare, përveçse krijojnë emocione të ndryshme tek ata, i ndihmon të kuptojnë gjuhën muzikore, të shprehin bukur dhe të vlerësojnë rreth *karakteristikave të ritmit, tingujve, ngjyimit, dinamikës* duke përdorur fjalë të thjeshta. Gjithashtu, pjesë të ndryshme muzikore i vendos nxënësit të zhvillojnë më tej botën e krijimit dhe të shprehjes, ata njohin kompozitorë të ndryshëm, pasurojnë njohuritë e tyre të përgjithshme të kulturës dhe njihen me shumëllojshmërinë e krijimeve artistike nga e kaluara dhe e tashmja, nga vendi dhe bota.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR ÇDO KOMPETENCË TË LËNDËS:

- *Krijimi muzikor*: provon të improvizojë mbi një këngë apo melodi ritmin dhe karakterin duke përdorur elemente të tjera si trupin.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: këndon dhe performon këngë dhe lojëra muzikore; komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; reflekton emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo pjesë muzikore gjatë interpretimit.
- *Vlerësimi i veprave muzikore*: bën lidhje ndërmjet asaj që përjeton dhe asaj që dëgjon nga një këngë, lojë muzikore apo fragment muzikor; shpreh mendimin e vet rreth këngës/pjesës që dëgjon; vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar punën e vet dhe të të tjerëve; ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA PËRGATITORE

› Muzika dhe emocioni përmes dëgjimit muzikor. Muzika shpreh:
- Dashuri.

- Zbulon tinguj, zhurma, goditje në mjedisin përreth dhe thotë si ndjehet.
- Imiton tingujt, zhurmat, zërat e ndryshëm, rrahjet që dëgjon në mjedisin përreth.

- Kënaqësi.
- Keqardhje.
- Gëzim.
- Shpresë.
- Mërzitje.
- etj.

› **Pjesë muzikore për dëgjim:**

- Këngë dhe lojëra për fëmijë

- Komenton me fjalë të thjeshta këngët që dëgjon (*shpejt, ngadalë, rëndë, ëmbël e bukur, e mërzitshme*).
- Shpreh emocionet për këngët dhe lojërat muzikore, që këndon apo dëgjon.
- Përdor simbole të ndryshme grafike, për të shprehur gjendje të ndryshme emocionale në nga muzika e dëgjuar.

KLASA 1

› **Mendimi muzikor dhe gjendja emocionale**

- Tinguj dhe ritme të ndryshme nga mjedisi
- Këngë dhe lojëra për fëmijë
- Hedwig's – John Williams, Tema e muzikës nga filmi Harri Potter (instrumentet e perkusionit)
- Canaries - Elliott Carter
- Fluturimi i brumbullit – N.R.Korsakov
- Marshi i martesës – F.Mendelson
- Can –can – Jachues Offenbach

- Shpreh emocionet përmes tingujve, ritmit dhe melodisë: *e gëzueshme, e trishtueshme, e qetë dramatike, irrituar, marsh, ëmbël*.
- Dëgjon me kujdes tingujt që e rrethojnë, dhe zbërthen domethënien e tyre.
- Përdor simbole të ndryshme grafike, për të shprehur gjendje të ndryshme emocionale në nga muzika që dëgjon.
- Dëgjon këngë dhe lojëra të thjeshta muzikore dhe shpreh emocionet lidhur me muzikën.
- Dëgjon fragmente muzikore dhe diskuton, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor: *e shpejtë, e ngadalë, e lartë, e ulët, e gëzueshme, e trishtueshme, e qetë, marsh* etj.
- Respekton përjetimin dhe vlerësimin e shokut dhe të shoqes, lidhur me fragmentin muzikor.
- Argumenton muzikën që dëgjon, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor.

KLASA 2

› **Forma muzikore: Kënga**

- Dëgjon këngë dhe lojëra të thjeshta muzikore, duke shprehur emocionet lidhur me muzikën.
- Kupton që kënga është *forma* më e thjeshtë muzikore.

› **Mendimi muzikor dhe Estetika**

- Dallon *muzikën e kënduar* dhe *muzikën e luajtur* nga instrumentet.

- Hedwig's – John Ęilliams, Tema e muzikės nga filmi Harri Poter (instrumentet e perkusionit)
- Fluturimi i brumbullit – N.R.Korsakov
- Ajri – J.S.Bach
- Marshi i martesės – F.Mendelson
- Oda e gėzimit – L.V.Bethoven
- Karnavelet e kafshėve – Camil Sen Sans
- Can –can – Jachues Offenbach
- Tokata dhe fuga nė D minor- J.S. Bach (glockenspil)
- Vallėzimi i Tarantelės – Xh. Rosini

- Shpreh emocionin e krijuar *pėrmes tingujve muzikorė; pėrmes ritmit, pėrmes timbrit/ngjyrimit.*
- Dėgjon me kujdes fragmente muzikore dhe kupton se mendimi muzikor shpreh njė emocion njerėzor.
- Pėrcakton gjatė dėgjimit konceptet e mėsuarat: *i fortė – i butė (p-f); gjysmė fort (mf); i lartė - i ulėt; shumė i ulėt – shumė i lartė, i gjatė i shkurtėr, i shpejtė i ngadaltė nė muzikė.*
- Pėrcakton gjatė dėgjimit rreth *karakteristikave tė ritmit, tingujve, ngjyrimit, dinamikės* duke pėrdorur fjalė tė thjeshta, nė fragmente tė vogla muzikore tė huaja dhe shqiptare.
- Krijon gjatė dėgjimit simbole grafike pėr tė prezantuar cilėsitė e tingujve *i lartė – i ulėt; i gjatė i shkurtėr; i butė – i fortė, i shpejtė i ngadaltė.*
- Diskuton gjendjen emocionale tė krijuar nga muzika, duke pėrdorur fjalor tė thjeshtė muzikor: *e gėzueshme, e trishtueshme, e qetė, dramatike, irrituar, marsh etj.*
- Respekton pėrjetimin dhe vlerėsimin e shokut dhe tė shoqes, lidhur me pjesėt muzikore qė dėgjon.

Qėndrime dhe vlera:

- Paraqet kuriozitet pėr fenomenet dhe dukuritė muzikore nė natyrė.
- Eksploron dhe zbulon fenomenet dhe dukuritė muzikore, duke shprehur mendimin e vet ndaj kėtyre dukurive.
- Tregon karakteristikat e ritmit dhe tingujve pėrmes pėrjetimit muzikor.
- Ndan idetė e veta pėr muzikėn.
- Shprehet artistikisht pėr njė pjesė muzikore.
- Tregon vetėbesim nė aktivitete tė ndryshme muzikore/artistike.
- Ka dėshirė pėr tu shprehur dhe komunikuar nė mėnyrė tė pavarur.
- Merr pjesė aktive nė veprimtaritė muzikore vetėm dhe nė grup.
- Pėrdor imagjinatėn dhe kreativitetin pėr tė krijuar dhe interpretuar.
- Demonstron kėmbėngulje nė krijimet muzikore.

- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari muzikore.
- Respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme.
- Tregon respekt për veten dhe të tjerët.
- Mban qëndrim ndaj këngëve dhe fragmenteve të ndryshme muzikore.
- Respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Vlerëson dhe shpreh frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë këndimit apo krijimit muzikor.
- Tregon përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE SHKALLA E DYTË: KLASA E TRETË, KLASA E KATËRT, KLASA E PESTË

1.4 Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Në këtë tematikë nxënësi/ja demonstroi kuptimin e ritmit me dy, tre dhe katër goditje, duke përdorur goditjen e shkurtër dhe goditjen e gjatë me rrokjet TA - A ose Ti - Ti ; TA -A-A; TA -TA -TA -TA; TA - A -A -A -A etj., duke vendosur *thaksin* atje ku duhet. Përmes ritmeve me dy, tre dhe katër goditje (duke përdorur instrumentet me goditje) si pjesë e gjuhës muzikore, nxënësi/ja fillon të ndërtojë njohuritë e veta mbi to dhe edukohet me ritmin dhe melodinë, mbi shpejtësinë dhe terminologjinë përkatëse si dhe bën klasifikimin e instrumenteve muzikore sipas grupimeve të tyre. Gjithashtu, ritmet me dy, tre dhe katër goditje përjetohen, krijohen dhe zhvillohen më tej nëpërmjet modeleve konkrete ritmike me mjete trupore ose instrumente me goditje. Njohja konkrete me lartësinë e tingujve përmes njohjes së *alfabetit muzikor* ndihmon nxënësit të luajnë edhe në instrumentin e fyellit apo të harmoniumit. Pra elementet e gjuhës muzikore, përjetohen dhe zbatohen në forma konkrete.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor*: krijon me modele ritmike me dy, tre dhe katër goditje; krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe me simbole duke vënë në pah *thaksin e fortë* gjatë ritmizimit të tyre; krijon duke përdorur simbole personale mbi këto ritme; krijon përmes simboleve muzikore që tregojnë shpejtësinë e muzikës si *adagio, andante, moderator, allegro etj.*
- *Performimi/interpretimi muzikor*: interpreton këngë në kohët 2,3,4 kohë; performon /interpreton këngët dhe lojërat muzikore; luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tre dhe katër goditje; interpreton këngë apo lojëra muzikore, duke demonstruar kuptimin shpejtësisë së muzikës sipas terminologjisë së mësuar; luan me fyell/harmonium sipas alfabetit muzikor.
- *Vlerësimi i veprave muzikore*: kupton dhe shpjegon ndryshimin ritmik tek këngët me dy, tre dhe katër goditje; bën lidhje të shembujve të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijohen, klasifikon zërat

dhe instrumentet muzikore që dëgjon sipas ngjyrimit dhe materialit që përbëhet instrumenti.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA 3

<p>> Ritmi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatësia, ¼ si njësi numërimi. - Ritmi me dy goditje – <i>theksi</i>. <p><i>Rrahje e gjatë – e shkurtër.</i></p> <p><i>Rrahje shumë e gjatë – shumë e shkurtër.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pausa ose pushimi në muzikë. <p>> Tempi:</p> <p><i>Adagio, andante, moderator, allegro.</i></p> <p>> Melodia;</p> <p>Dinamika .</p> <p>Shenjat e ngjyrimit: <i>pp - p - mp - mf - f ff; kreshendo dhe dekreshendo.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Gjen fjalë me 2 rrokje dhe të përcakton <i>theksin</i> gjatë shqiptimit të fjalës. - Përdor gjatësinë ¼ si njësi numërimi për të krijuar modele të ndryshme ritmike. - Krijon modele me 2 goditje sipas dëshirës. - Kupton <i>ritmin me dy goditje</i>, duke e prezantuar atë me simbole të ndryshme grafike. - Përjeton rrahjen ritmike, p.sh., <i>marsh</i> – marshojnë, duke rrahur/mbajtur ritmin me 2 goditje dhe theksuar <i>goditjen e parë</i>. - Kupton dhe përjeton <i>pushimin</i> në muzikë. - Përdor <i>mjete trupore</i> të ndryshme, për të krijuar modele ritmike me 2 goditje. - Kupton shpejtësinë e muzikës së <i>ngadaltë, mesatare</i> dhe të <i>shpejtë: adagio, andante, moderato, allegro</i> në muzikë. - Dallon <i>shenjat e ngjyrimit</i> gjatë interpretimit të një kënge apo dëgjimit të një vepre muzikore. - Respekton shenjat e ngjyrimit <i>pp - p - mp - mf - f - ff) kreshendo</i> dhe <i>dekreshendo</i>.
---	--

KLASA 4

<p>> Ritmi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ritmi me tri goditje – <i>theksi</i> - Ritmi me katër goditje – <i>theksi</i> - Pausa /pushimi muzikor <p>> Tempi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Lento, Allegretto, Accelerando, Rallentando</i> 	<ul style="list-style-type: none"> - Përjeton rrahjen ritmike me 3 goditje: <i>vals</i> – vallëzojnë, duke mbajtur ritmin me 3 goditje dhe theksuar <i>goditjen e parë</i>. - Kupton dhe përjeton pushimin në rrahjet me 2 3 dhe 4 goditje. - Gjen fjalë me 3 dhe 4 rrokje dhe të përcakton <i>theksin</i> gjatë shqiptimit të fjalës. - Krijon modele ritmike me 2 -3 dhe 4 goditje, duke i prezantuar ato me simbole të ndryshme grafike. - Përdor mjetet trupore për të krijuar modele ritmike me 2, 3 dhe 4 goditje. - Kupton shpejtësinë e muzikës së <i>ngadaltë, mesatare</i> dhe të <i>shpejtë: Lento, Allegretto,</i>
---	--

<ul style="list-style-type: none"> › Melodia: - Notat sipas alfabetit: C,D,E,F,G,A,B,C. 	<p style="text-align: center;"><i>Accelerando, Rallentando.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Njeh lartësinë e tingujve përmes alfabetit muzikor: C,D,E,F,G,A,B,C.
KLASA 5	
<ul style="list-style-type: none"> › Ritmi: - Gjatësia, $\frac{1}{4}$ si njësi numërimi. - Ritmi me 2, 3 dhe 4 goditje . › Klasifikimi i zërave dhe instrumenteve : - Klasifikimi i zërave vokale: <i>fëmijëve, grave dhe burrave.</i> - Klasifikimi i instrumenteve muzikore: <i>idionë, membranofonë, kordofonë, aerofonë, elektrike.</i> › Media: - Tinguj të prodhuar nga mjete të ndryshme teknologjike: softëere, sintetizator etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton gjatësinë me një goditje si njësi numërimi në muzikë. - Përjeton rrahjet <i>e gjatë – e shkurtër ; shumë e gjatë – shumë e shkurtër</i> përmes modeleve konkrete. - Krijon modele ritmike me 2 -3 dhe 4 goditje, duke i prezantuar ato me simbole të ndryshme grafike. - Kupton dhe përjeton pushimin në rrahjet me 2, 3 dhe 4 goditje. - Klasifikon zërat vokale sipas zërave: të fëmijëve, grave dhe burrave. - Klasifikon instrumentet muzikore sipas grupeve të instrumenteve: idionë, membranofonë, kordofonë, aerofonë, elektrike. - Prodhon punë të veta muzikore sipas njohurive të marra, duke përdorur media dhe teknologji të ndryshme dhe i prezanton ato në klasë.

1.5 Tematika: Teknika dhe procese muzikore

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Proceset muzikore që vazhdojnë të zhvillohen dhe përshkojnë muzikën në tërësi janë: këndimi, luajtja në instrumente muzikore për fëmijë, përjetimi, interpretimi, dëgjimi muzikor, krijimi, improvizimi, analizimi, të cilat zhvillohen nëpërmjet teknikave të ndryshme të kënduarit, luajtjes në instrument, të dëgjuarit etj. Përmes të kënduarit do të perfeksionohen mënyrat e formësimit të zërit dhe të një kënduari të saktë në intonacion e ritëm. Përmbajtjet e këngëve duhet të jenë të thjeshta dhe të kenë një tematikë të caktuar: *himni, atdheu, familja, shoqëria, këngët patriotike dhe festat e ndryshme* etj., po kështu edhe *këngët/lojë muzikore* apo *popullore* (sugjerohen deri në klasë të tretë). Ato duhet të jenë didaktike dhe të kenë vlera artistike muzikore, edukative dhe poetike, të cilat edukojnë për një qëllim të caktuar, ndaj tematika dhe shumëllojshmëria e tematikave është e detyrueshme. Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga *shtrirja e regjistrit vokal* (zërit), *melodia dhe ritmi*. Luajtja me instrumentet trupore, instrumentet me goditje dhe ORF, do të jenë pjesë e shoqërimit të këngëve dhe improvizimit me to, apo të muzikës që nxënësit këndojnë, vallëzojnë dhe luajnë. Ndërsa luajtja në instrumentin e *fyellit apo harmoniumit* përmes *alfabetit muzikor* është një lojë zbavitëse muzikore për nxënësit nëpërmjet instrumentit.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor*: komunikon qartë njohuritë që zotëron rreth gjuhës muzikore duke shpjeguar emocionet e këngës apo lojës muzikore.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës; interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore; demonstroi zbatimin e elementeve të gjuhës muzikore të mësuara në këtë shkallë, gjatë këndimit apo gjatë luajtjes në instrumente të thjeshta për fëmijë; performon/interpreton këngët në eventet e klasës apo të shkollës.
- *Vlerësimi i veprave muzikore*: shpreh emocionet e veta për këngët që këndon; përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional; përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; ndaj përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera.

Njohuritë për realizimin e

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

kompetencave të lëndës**KLASA 3**

› Këngë të thjeshta për fëmijë në kohët 2/4, ¾, 4/4.

› Rregullat e këndimit.

› Lojëra muzikore për fëmijë.

› Instrumente ORF:

- Glockenspili.
- Ksilofoni.
- Metalofoni.

- Këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla etj.), në kohët 2/4, ¾, 4/4, me regjistër të thjeshtë vokale, me shtrirje brenda oktavës qendrore, nga notat Do – Do².
- Respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit.
- Respekton gjatë këndimit *ritmin, intonacionin, rregullat e këndimit*.
- Këndon këngë për fëmijë *solo dhe në grup*.
- Interpretin këngët e mësuara me emocion dhe ndjenjë.
- Këndon dhe performon sipas një koreografie të ideuar për këngë – lojëra muzikore.
- Këndon dhe interpreton lojërat muzikore *popullore* për fëmijë të krahinës ose më tej;
- Shoqëron lojërat muzikore dhe popullore me mjete trupore (shuplaka) apo me vegla me goditje (shkopinj, tambur, zilka etj).
- Provon të krijojë dhe luan me instrumentet ORF: ksilofon, glockenspil.
- Merr pjesë në aktivitetet e klasës dhe shkollës.
- Regjistron krijimet e tyre me instrumente dhe zë (luajtje apo shoqërime me instrumente dhe këngë etj.) në magnetofonin e klasës, shkollës.

KLASA 4

› Këngë të thjeshta për fëmijë .

› Rregullat e këndimit.

› Këndimi solo dhe në grup.

› Instrumenti i fyellit/harmonim:

- Rregullat e luajtjes në instrument
- Qëndrimi
- Teknika të luajtjes me to

- Këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla etj.), në kohët 2/4, ¾, 4/4, me regjistër të thjeshtë vokale, me shtrirje brenda oktavës qendrore, nga notat Do – Do².
- Respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit.
- Respekton gjatë këndimit *ritmin, intonacionin, rregullat e këndimit*.
- Këndon *solo dhe në grup*.
- Interpretin këngët e mësuara me emocion dhe ndjenjë.

- Luan në instrumentin e fyellit sipas alfabetit muzikor pjesë shumë të thjeshta.
- Respekton rregullat e luajtjes në instrument.
- Merr pjesë në aktivitetet e klasës dhe shkollës.
- Regjistron krijimet e tyre me instrumente dhe zë (luajtje në instrument dhe këngë në magnetofonin e klasës, shkollës).

KLASA 5

<ul style="list-style-type: none"> > Këngë të thjeshta për fëmijë : - Rregullat e këndimit. > Këndimi solo dhe në grup. > Kënga patriotike. > Kënga partizane. > Kënga himn. > Instrumenti i fyellit/harmonim: - Rregullat e luajtjes në instrument. - Qëndrimi . - Teknika të luajtjes me to. 	<ul style="list-style-type: none"> - Këndon këngë me tematika të larmishme (atdheu, familja, natyra, shoqëria, shkolla , himn, partizane dhe patriotike në kohët 2/4, ¾, 4/4 , me regjistër të thjeshtë vokal, me shtrirje brenda oktavës qendrore, nga notat Do – Do². - Respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit. - Respekton gjatë këndimit <i>ritmin, intonacionin, shenjat dinamike</i>. - Këndon <i>solo dhe në grup</i>. - Interpretet këngët e mësuara me emocion dhe ndjenjë. - Luan në instrumentin e fyellit /harmonim sipas alfabetit muzikor pjesë shumë të thjeshta. - Respekton rregullat e luajtjes në instrument. - Merr pjesë në aktivitetet e klasës dhe shkollës. - Regjistron krijimet e tyre me instrumente dhe zë (luajtje në instrument dhe këngë në magnetofonin e klasës, shkollës).
--	---

1.6 Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Dëgjimi muzikor dhe të shprehurit përmes saj është një element shumë i rëndësishëm në muzikë, i cili shprehet jo vetëm përmes emocioneve njerëzore. Muzika krijon emocione, që shprehin: dashuri, kënaqësi, keqardhje, gëzim, shpresë, mërzi. Përmes marrjes dhe kuptimit të njohurive muzikore dhe dëgjimit muzikor edukohet te nxënësit dëshira për muzikën dhe i bën ata më të vetëdijshëm ndaj muzikës që dëgjojnë. Pjesët muzikore të huaja dhe shqiptare, përveçse krijojnë emocione të ndryshme tek ata, i ndihmojnë të kuptojnë gjuhën muzikore, të shprehen bukur dhe të diskutojnë rreth njohurive që kanë marrë rreth *karakteristikave të ritmit, tingujve, ngjyrimit, dinamikës, apo jetës së kompozitorëve* duke njohur dhe respektuar muzikën e vendit të vet dhe të tjerëve, duke njohur dhe dalluar karakteristikat e muzikës së tyre dhe vlerësuar saktë emocionalisht ato.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor:* kupton përmes fragmenteve të ndryshme muzikore, gjuhën muzikore, *ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, shpejtësinë muzikore, lartësinë e tingujve, karakterin* e pjesëve muzikore kur luhen ose këndohen; improvizon mbi një këngë apo melodi sipas ritmit apo karakterit të melodisë.
- *Performimi/interpretimi muzikor:* komunikon mendimin e vet rreth këngës së interpretuar; interpreton dhe reflekton emocionet që i krijon një këngë, apo pjesë muzikore gjatë interpretimit; vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve.
- *Vlerësimi i veprave muzikore:* bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; bën gjykime kritike dhe estetike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, *ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, shpejtësinë muzikore, lartësinë e tingujve, karakterin* e pjesëve muzikore; ndan përvojën/mendimin e vet artistik me të tjerët; shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore gjatë argumentimit të ndjenjës emocionale që i shkakton muzika; përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve; respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA 3

> Integrimi i muzikës tema ose arte të tjera:

- Insektet

- Fluturimi i brumbullit .
N.R.Korsakov.
- Grenza - Ralph Vaughan Ëilliams.
- Ferma.
- Karanavali i kafshëve – Camil Sen Sans.
- Delet kullosin qetë – J.S.Bach.
- Pylli
- Peteri dhe Ujku – Prokofjev

- Reagon ndaj muzikës që dëgjon duke përdorur mjetet trupore, lëvizjet trupore, instrumentet me goditje për të shoqëruar atë.
- Integron muzikën me tema apo artet e tjera.
- Përjeton muzikën sipas *ritmit, shpejtësisë, ngjyrimit, dinamikës* në mënyra të ndryshme për t'i shprehur sa më mirë kuptimin e tyre.
- Përdor imagjinatën për të shprehur emocionet që i krijon vepra muzikore me kërcim, vizatim etj.
- Dëgjon fragmente muzikore dhe diskuton gjendjen emocionale të krijuar nga muzika, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor: *e gëzueshme, e trishtueshme, e qetë, dramatike, irrituar, marsh, e shpejtë, e ëmbël* etj.
- Respekton përjetimin dhe vlerësimin e shokut dhe të shoqes, lidhur me pjesët muzikore që dëgjon.

KLASA 4

Veprat muzikore dhe kompozitori:

- Fluturimi i brumbullit – N.R. Korsakov
- Karnavalet e kafshëve – Camil Sen Sans.
(*breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri*).
- Ajri – J.S.Bach.
- Marshi i martesës – F.Mendelson.

- Reagon ndaj muzikës që dëgjon duke përdorur mjetet trupore, lëvizjet trupore, instrumentet me goditje për të shoqëruar atë.
- I përgjigjet muzikës që dëgjon nëpërmjet njohurive të marra për *ritmin, shpejtësisë, ngjyrimit, dinamikës* me fjalët e veta.
- Dëgjon fragmente muzikore dhe diskuton gjendjen emocionale të krijuar nga muzika, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor: *e gëzueshme, e trishtueshme, e qetë, dramatike, irrituar, marsh, e shpejtë e ëmbël* etj.
- Përjeton muzikën sipas *ritmit, shpejtësisë, ngjyrimit, dinamikës* në mënyra të ndryshme për t'i shprehur sa më mirë kuptimin e tyre.

<ul style="list-style-type: none"> - Karnavelet e kafshëve – Camil Sen Sans. - Can –can – Jachues Offenbach. - Tokata dhe fuga në D minor- J.S. Bach (glokenshpil). 	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon me fjalë të thjeshta karakteristikat e muzikës që dëgjon dhe veçon dallimet që kanë ato nga njëra tjetra. - Njeh jetën e kompozitorit të pjesës që dëgjon. - Lidh emocionet me imagjinatën që i krijon vepra muzikore. - Respekton përjetimin dhe vlerësimin e shokut dhe të shoqes, lidhur me pjesët muzikore që dëgjon.
--	---

KLASA 5

<p>Veprat muzikore dhe kompozitori:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fluturimi i brumbullit – N.R Korsakov. - Karnavelet e kafshëve – Camil Sen Sans. <i>(breshka, elefanti, luani, peshqit, zogjtë, kanguri).</i> - Ajri – J.S.Bach. - Marshi i martesës – F.Mendelson. - Oda e gëzimit – L.V.Bethoven. - Karnavelet e kafshëve – Camil Sen Sans. - Can –can – Jachues Offenbach. - Tokata dhe fuga në D minor- J.S. Bach (glokenshpil). - Vallëzimi i tarantelës – Xh. Rosini - Arrëthyesi – P.I. Çajkovski. 	<ul style="list-style-type: none"> - Dëgjon fragmente muzikore dhe diskuton gjendjen emocionale të krijuar nga muzika, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor: <i>e gëzueshme, e trishtueshme, e qetë, dramatike, irrituar, marsh, e shpejtë e ëmbël etj.</i> - Përjeton muzikën sipas <i>ritmit, shpejtësisë, ngjyrimit, dinamikës</i> në mënyra të ndryshme për t'i shprehur sa më mirë kuptimin e tyre. - Reagon ndaj muzikës që dëgjon duke përdorur mjetet trupore, lëvizjet trupore, instrumentet me goditje për të shoqëruar atë. - I përgjigjet karakterit të muzikës që dëgjon edhe nëpërmjet arteve të tjera, si: <ul style="list-style-type: none"> - <i>duke kërcyer,</i> - <i>duke krijuar një poemë apo histori,</i> - <i>duke ilustruar nëpërmjet artit pamor;</i> - Shpjegon me fjalë të thjeshta karakteristikat e muzikës që dëgjon dhe veçon dallimet që kanë ato nga njëra tjetra. - Dallon muzikën e kënduar dhe muzikën instrumentale gjatë dëgjimit. - Njeh jetën e kompozitorit të pjesës që dëgjon. - Lidh emocionet me imagjinatën që i krijon vepra muzikore.
---	--

- Respekton përjetimin dhe vlerësimin e shokut dhe të shoqes, lidhur me pjesët muzikore që dëgjon.

Qëndrime dhe vlera:

- Dëgjon dhe shpreh përmes dëgjimit, karakteristika të muzikës përmes fjalës, lëvizjes, krijimit.
- Shprehet rreth karakteristikave e ritmit dhe melodisë përmes dëgjimit.
- Shpreh idetë e veta për muzikën që dëgjon.
- Shprehet duke komunikuar artistikisht për një pjesë muzikore.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme muzikore/artistike.
- Shprehet dhe komunikon në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë muzikore vetëm dhe në grup.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për të krijuar dhe interpretuar muzikën në grup.
- Demonstron vetëbesim në krijimet e veta muzikore vetëm ose në grup.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari muzikore.
- Respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme muzikore që dëgjon.
- Respekton krijimet e veta dhe të tjerëve.
- Mban qëndrim ndaj këngëve dhe fragmenteve të ndryshme muzikore.
- Njih dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe atë të kulturave të tjera.
- Zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë këndimit apo krijimit muzikor.
- Demonstron përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

IV. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve të muzikës është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata përjetojnë dhe provojnë vetë dukuritë dhe fenomenet muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar e cila arrihet nëpërmjet rezultateve të të nxënësve dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e muzikës, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet në *mësimdhënien e nxënësve bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësve dhe mësimdhënien e nxënësve të integruar.*

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për nga mënyrën se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënësve të muzikës;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin dhe ndërtimin e çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe edukimin e aftësive bazë muzikore;
- rëndësinë e zbatimeve krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;

- rëndësinë e përdorimit të mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e interpretimit në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat muzikore të përcaktuara në këtë program, zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve në muzikë. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, zbulime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime/performime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “..pse më pëlqen?”, “...” ku e kam dëgjuar më parë këtë melodi...?”, “...a është melodioze?”, “..çfarë ndodh nëse e këndojmë më lart?” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Diskutimet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësitë për mirënjohje mësimdhënies dhe të pajisin nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive muzikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (p.sh: vetëvlerësimi, interpretim i një liste këngësh dhe lojërash muzikore për fëmijë, portofol me punë muzikore, prezantim i krijimeve të ndryshme të realizuara).

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në muzikë, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e krijimit individual, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirjet e veta të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale. *Inkurajimi, imagjinata muzikore, shprehja origjinale dhe krijuese, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve muzikore janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në muzikë dhe arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale por edhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë puna për formimin e kompetencave muzikore tek nxënësit, që ai/ajo të jetë në gjendje të krijojë, performojë/interpretojë dhe vlerësojë saktë dhe bukur muzikën. Arritjet në fushën e muzikës dhe të arteve janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave muzikore, që arrin të zhvillojë dhe demonstrojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes *të kënduarit, dëgjuarit muzikor, të krijuarit, të analizuarit të pjesëve artistike* etj.

Portofoli i nxënësit, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në muzikë. Ai mund të përmbajë krijime, projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme të CD-ve e DVD-ve në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, etj.

Vlerësimi i nxënësve në shkallën e tretë dhe të katërt bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

VI. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimin të muzikës për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime të ndryshme, të cilat nxënësi i dëgjon, i përjeton, i shikon, i përdor, etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm muzikorë, krijon mjedisin për aktivitete alternative etj. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit të zbulojnë dhe përjetojnë njëkohësisht këngë, lojëra muzikore, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e muzikës.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës muzikore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/ajo u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtjet e caktuara ose shkathtësitë që ata duhet të performojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medieve detyra dhe projekte të ndryshme.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh.: instrumentet ORF, ndërsa për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, këngëve përdoren magnetofoni, TV, CD dhe DVD .

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet pamore natyrore si:* objektet natyrore që shërbejnë për të demonstruar tingujt, zhurmat, etj.
- *Mjetet audiovizive si:* Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon, kasetofon etj.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të

diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në kryerjen e krijimeve të ndryshme.

- *Mjedisi mësimor si:* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).